

FC DRITA SH.P.K.

RAPORTI I AUDITIMIT NGA AUDITORI I PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025



FC DRITA SH.P.K.

NUI: 811186974

DEKLARATË E PAJTUESHMËRISË

- Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2025

Dekloroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2025 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06-/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Drejtori i
përgjithshëm/ekzekutiv



Drejtor Financiar /
Kontabilist i Çertifikuar

<u>PERMBAJTJA</u>	Faqe
RAPORT I AUDITIMIT NGA AUDITORI I PAVARUR	4-5
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	6
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	9
1 Të përgjithshme	10
2 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit	10
3 Menaxhimi i riskut financiar	14
4 Paraja në arkë dhe në bankë	16
5 Llogaritë e arkëtueshme transferit te lojtareve	16
6 Llogaritë e arkëtueshme	16
7 Pasuritë tjera afatshkurtëra	16
8 Kerkesat tjera ndaj huave te dhena	16
9 Prona	17
10 Investimet ne vijim	18
11 Kerkesat tjera afatgjata	18
12 Huate a afatgjata	18
13 Llogarite e pagueshme ndaj punonjesve	18
14 Llogarite e pagueshme	18
15 Detyrimet ndaj tatimeve	19
16 Te hyrat e shtyra	19
17 Detyrimet ndaj huave afatgjata	19
18 Kapitali	19
19 Te hyrat nga aktivitetet	20
20 Kosto e mallit të shitur	20
21 Shpenzimet e perfituesve te lojtareve	21
22 Shpenzimet e perfituesve te punonjeve tjere	21
23 Shpenzimet operative	21
24 Tatimi ne fitim	22
25 Transakcioni me pale te lidhura	22
26 Zotimet dhe kontigjentet	23
27 Ngjarjet pasuese	23

RAPORT I AUDITIMIT NGA AUDITORI I PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e FC DRITA SH.P.K.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të FC DRITA SH.P.K. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2025 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2025 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM).

Çështje të tjera

- FC Drita Sh.p.k. ka përmbushur kriteret siç përcaktohen në aneksin G të rregullores së UEFA's, që përfshin standarde të kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF për NVM dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose

gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënien anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfarëdo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Fahri Breznica
Auditor Ligjor




Quatra Audit Int. L.L.C., Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë H1, nr 2
25 mars 2026

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR Më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro)


Pershkrimi	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Pasuria afatshkurter			
Paraja dhe ekuivalentet e saj	4	132,495	21,763
Llogarite e arketueshme nga transferi i lojtareve	5	4,000	4,000
Llogarite e arketueshme nga personat e lidhur			
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	6	1,205,110	4,000
Pasurite tatimore	7	100,235	48,979
Malli ne garancion		-	
Kërkesa tjera	8	63,200	63,200
Gjithsej pasurite qarkulluese		1,505,039	141,942
Pasuria afatgjate			
Prona, fabrika dhe paisjet	9	6,383	3,169
Pasurite e paprekshme lojtaret			
Investimet ne vijim	10	80,104	37,795
Llogarite e arketueshme nga transferi i lojtareve			
Llogarite e arketueshme nga personat e lidhur			
Kerkes tjera ndaj aksionareve	11	130,000	130,000
Kerkesa ndaj huave afatgjata	12	85,500	91,000
Gjithsej pasurite afatgjata		301,988	261,964
Gjithsej pasurite		1,807,027	403,906
Detyrimet afatshkurtera			
Overdraft bankar			
Kredite bankare dhe te tjera			
Llogarite e pagueshme te personave te lidhur			
Llogarite e pagueshme te punonjesve	13	-	106,631
Llogarite e pagueshme per obligime sociale			
Aktualet dhe pasivet tatimore			
Llogarite e pagueshme dhe tjera	14	15,028	17,275
Depozitat afatshkurtera			
Te hyrat e shtyra			
Detyrime tjera afatshkurtera			
Detyrimet për taksa	15	187,787	40,045
Totali i detyrimeve afatshkurtëra		202,815	163,951
Detyrimet afatgjata			
Kredite bankare dhe te tjera			
Llogarite e pagueshme te personave te lidhur			
Llogarite e pagueshme te punonjesve			
Llogarite e pagueshme per obligime sociale			
Llogarite e pagueshme dhe tjera			
Akrualet dhe pasivet tatimore aktuale			
Te hyrat e shtyra	16	398,800	-
Detyrime tjera te huave			
Detyrimet për taksa			
Detyrimet tjera joaktuale-huazimet	17	-	401,000
Totali i detyrimeve afatgjata		398,800	401,000
Totali i detyrimeve		601,615	564,951
Kapitali			
Kapitali aksioner	18	150,000	150,000
Fitimi/Humbja e vitit	25	1,366,456	(234,130)
Fitimi/Humbja e mbajtur	25	(311,045)	(76,915)
Totali i kapitalit		1,205,411	(161,045)
Totali i kapitalit dhe i detyrimeve		1,807,027	403,906

Më 27 shkurt 2026 këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe aprovuar nga:



Feti Murseli

Drejtori i ekzekutiv



Ilaz Shkodra

Drejtor financiar



Mirlinda Murtezi

Kontabiliste e Çertifikuar

Shënimet shoqëruese nga 1 në 27 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro)

<u>Pershkrimi</u>	<u>Shenim</u>	<u>Per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2025</u>	<u>Per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2024</u>
Te hyrat nga marketingu	19	19,153	35,382
Te hyrat nga Sponsorizimi	19	398,800	195,500
Te hyrat nga te drejtat televizive	19	168,640	66,150
Te hyrat nga shitja lojtareve	19	88,357	374,890
Te hyrat nga FFK	19	-	126,190
Te hyrat nga biletat	19	52,064	-
Te hyrat nga UEFA per zhvillim	19	-	-
Te hyrat nga UEFA	19	5,264,546	1,274,939
Te hyrat tjera	19	4,695	28,846
Te hyrat e shtyra	19	(398,800)	-
Totali I te ardhurave		5,597,455	2,101,896
Shpenzimet			
Kosto e sherbimeve	20	(767,586)	(449,577)
Sherbimet e perfitimit te punonjsve-lojtareve	21	(1,970,657)	(1,173,956)
Sherbimet e perfitimit te punonjsve- tjerë	22	(1,120,879)	(539,350)
Amortizimi /Zhvleresimi I aseteteve themelore fikse			
Zhvlersimit i aseteteve te prekshme dhe/aktiveve jo materiale	23	(3,166)	(2,686)
Shpenzimet tjera operative	24	(229,409)	(170,456)
Gjithsej shpenzimet operative		(4,091,697)	(2,336,025)
Fitimi Operativ		1,505,758	(234,128)
Tregtimi I lojtareve			
Amortizmi i aktiveve jo-materiale			-
Zhvleresimi i aktiveve jo-materiale			-
Fitimi/Humbja nga shitja e lojtareve			-
Kosto e regjistrimit te lojteve			-
Te ardhurat ne dispozicion nga regjistrimet e lojtareve			-
Totali nga shitja e lojtareve			-
Fitimi/Humbja ne dispozicion te aseteteve te prekshme			-
Fitimi/Humbja ne dispozicion te aktiveve te tjera jo-materiale			-
Totali i fitimit/humbjes ne dispozicion te aseteteve fikse			-
Rezultati financiar			-
Te ardhurat financiare			-
Kostot financiare			-
Fitimet /humbjet e kembimit valutor neto			-
Te ardhurat neto financiare/shpenzimet			-
Te ardhurat tjera jo operative			-
Shpenzimet tjera jo operative			-
Fitimi/(Humbja) para tatimit	24	1,505,758	(234,128)
Tatimi mbi fitimin	24	139,301	-
Fitimi/(Humbja) neto i periudhës	24	1,366,457	(234,128)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		1,366,457	(234,128)

Shënimet shoqëruese nga 1 në 27 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FC DRITA SH.P.K.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro)

	Kapitali aksionar	Fitim I mbajtur	Fitim I periudhes	Tërheqjet e pronarit	Gjithsej
Balanca me 1 Janar 2024	150,000	(76,915)			73,085
Fitimi/Humbja e vitit		(234,130)			(234,130)
Diferencat nga kembimet valutore					
Dividenta/Tërheqjet					
Deponimet e kapitalit shtese					-
Ndarja e rezervava					
Balanca me 31 Dhjetor 2024	150,000	(311,045)	-	-	(161,045)
Fitimi/Humbja e vitit		1,366,456			1,366,456
Diferencat nga kembimet valutore		-	-	-	-
Dividenta/Tërheqjet					
Deponimet e kapitalit shtese					
Ndarja e rezervave					
31 Dhjetor 2025	150,000	1,055,412	-	-	1,205,412

Shënimet shoqëruese nga 1 në 27 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FC DRITA SH.P.K.

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro)

Shenime	Për vitin që përfundoa më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundoa më 31 dhjetor 2024
Rrjedhjet e arkës nga aktivitetet operative		
Arketimet e parase nga faturat e hyrjes në stadion	18	52,064
Te hyrat nga reklamat	18	18,153
Arketimet e parase nga sponsorizimi	18	398,800
Arketimet e parase nga te drejtat e transmetimit	18	168,640
Arketimet e parase nga shitje e lojtarëve	18	88,357
Arketimet e parase nga UEFA	18	4,064,436
Arketimet e parase nga FFK		-
Arketimet e parase nga pagesat e tjera të aktiviteteve	18	4,695
Pagesat me para të gatshme për furnizime për mallra dhe shërbime		-
Pagesat me para të gatshme për dhe në emer të punonjësve	20-21	(3,106,797)
Pagesat me para të gatshme të bera për agjentët		-
Pagesat me para të gatshme të bera në lidhje me shpenzimet tjera operative	19-23	(1,128,558)
Pagesat me para të gatshme për furnizime për mallra dhe shërbime		-
Rrjedhjet neto e parase nga aktivitetet operative		559,790
Rrjedhjet e arkës nga aktivitetet investive		
Arketimet e parase nga aktivitetet investive		-
Arketimet e parase nga shitja e lojtareve të regjistruar		-
Arketimet e parase nga blerja e lojtareve të regjistruar		-
Arketimet e parase nga shitja e aseteve fikse		-
Pagesat me para të gatshme për blerjen e aseteve	9.-10	(11,249)
Pagesat me para të gatshme për shitjen e aseteve		-
Pagesat me para të gatshme për marrjen e aseteve tjera		-
Pagesat me para të gatshme për shitjen e investimeve financiare		-
Pagesat me para të gatshme për marrjen e investimeve financiare të reja		-
Pagesat me para të gatshme për aktivitete tjera investive (Investimet në vijim)	10	(42,309)
Rrjedhjet neto e parase nga aktivitetet investive		(53,558)
Rrjedhjet e arkës nga aktivitetet financuese		
Arketimet e parase nga huazimet ndaj aksionareve	17	(401,000)
Ripagesat me para të gatshme ndaj aksionareve		-
Pagesa e parase për huazimet e dhena		-
Arketimet e parase për huazimet	12	5,500
Arketimet e parase nga rritja e kapitalit		-
Pagesa e parase për dividende ndaj pronarëve		-
Arketimet nga dhenja e obligacioneve		-
Ripagesat me para të gatshme në lidhje me ripagesën e obligacioneve		-
Ripagesat me para të gatshme për aktivitete tjera financiare		-
Rrjedhjet neto e parase nga aktivitetet financuese		(395,500)
Rritja/Ulja neto e parase së gatshme		110,732
Rikonsulimi		
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit		21,763
Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit valutator		-
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit		132,495

Shënimet shoqëruese nga 1 në 27 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

1. TË PËRGJITHSHME

“FC DRITA” SH.P.K. (që më poshtë do t’i referohemi si “FC DRITA” ose “Shoqëria”) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 22.07.2016 dhe është e regjistruar me nr unik 811186974 në Regjistrin e Shoqërive Tregtare prane Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Selia e regjistruar e Shoqërisë dhe vendi kryesor i aktivitetit është në Gjilan, Stadiumi i Qytetit p.n., Republika e Kosovës.

Aktiviteti kryesor i biznesit të Shoqërisë është aktiviteti sportiv ,kurse kapitali themelor i Shoqërisë ishte 150,000.00 € i regjistruar në ARBK dhe 20,000 i paguar.

Shoqëria ka dy aksionare sipas Listes dhe Aneksit si dhe Informateve mbi biznesin ne ARBK.

Shoqëria gjatë vitit 2024 ka pasur mesatarisht 51 të punësuar(2023:45). Drejtori i autorizuar menaxhon me Shoqerine. Shoqeria ke te regjistruar keto aktivitete ne ARBK :

Aktiviteti primar

9312 Aktivitetet e klubeve sportive

Aktiviteti sekondar

9313 Palestra e fitnesit

Aktiviteti tjera

9319 Aktivitetet e tjera sportive

Klubi futbollistik FC Drita është e regjistruar që të merr pjesë në gara të kampionatit kombëtar, kupën kombëtare,gara ndërkombëtare, ndeshje miqësore, organizimin e trajnimeve të futbollit si dhe grupmoshave te reja.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1. Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur ne përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM) dhe kerkesave të kritereve financiare nga UEFA.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat matëse te specifikuara ne procedura për çdo lloj të aseteve, të detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë plotësisht të përshkruara në politikat e kontabilitetit më poshtë.

2.2. Valuta e paraqitur

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 janar 2002.

2.3. Shkëmbimi i valutës së huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë shkëmbyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet në valutat huaja që rezultojnë nga rregullimet e transaksioneve të tilla si dhe nga ri-matjet e zërave monetar me kurset e këmbimit të fund vitit paraqiten si fitim ose humbje.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

2.4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-në, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.5. Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat e pozitës financiare dhe ajo e të ardhurave, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon që kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe ti mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.6. Stoqet

Stoqet vlerësohen në koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes në kursin e zakonshëm të biznesit, minus kosto e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes.

Kostot e furnizimit janë vendosen duke përdorur metodën e ponderuar mesatare dhe përfshin shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre.

2.7. Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjeve janë paraqitur me kosto historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar. Kosto historike përfshin shpenzimet që i atribuohen direkt artikujve të përvetësuar. Deri me tani nuk është bere rivlerësimi i pronave, impianteve dhe pajisjeve.

Blerjet e mëvonshme janë të përfshirë në vlerën bartëse të asetit ose paraqiten si aset i veçantë, përkatësisht, vetëm kur ka një gjasë të fluksit të ardhshëm të përfitimeve ekonomike të kompanisë nga artikulli përkatës, dhe kur vlera e artikullit mund të matet në mënyrë të arsyeshme. Zhvlerësimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën drejtë -vizore për shpërndarjen e koston ose koston e konsideruar tek vlera mbetur e tyre përgjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit, si në vijim :

	<u>2025</u>	<u>2024</u>
Ndërtesa	5%	5%
Investimet në objektet me qira	5-10%	5-10%
Pajisjet	20%	20%
Mjetet tjera motorike transportuese	20%	20%
Veturat dhe pajisjet tjera	20%	20%

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date të raportimit.

2.8. Tatimi në të ardhura aktuale dhe të shtyra

Detyrimi i tatimi aktual mbi të ardhurat është llogaritur në bazë të ligjit tatimor mbi te ardhurat e korporatave në fuqi në datën e bilancit të gjendjes.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave është siguruar në mënyrë të plotë, duke përdorur metodën e detyrimeve, mbi diferencat e përkohshme që rrjedhin në mes bazës tatimore të aseteve dhe detyrimeve dhe vlerë bartëse të tyre në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë i të ardhurave përcaktohet duke përdorur një normë tatimore që ka qenë në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë i të ardhurave përcaktohet duke përdorur një normë tatimore që ka qenë në fuqi nga data e bilancit të gjendjes dhe pritet që të aplikohet kur pasuria përkatëse e tatimit të shtyrë në të ardhura është realizuar ose detyrimi i tatimit të shtyrë në të ardhura është shlyer.

Pasuria e tatimit të shtyrë në të ardhura njihet deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundër të cilit diferencat e përkohshme mund të përdoren.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)***2.9. Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura në banka dhe investime afatshkurtër me likuiditet të lartë që skadojnë brenda një periudhe deri në 12 muaj.

2.10. Ekuiteti, rezervat, fitimet e bartura dhe pagesat e dividendëve**- Kapitali aksionar**

Kapitali prej 150,000 Euro është i regjistruar në ARBK dhe i paguar është 20,000 Euro.

- Fitimet e bartura

Fitimet e bartura përbëhen nga fitimet e pa shpërndara nga periudhat e kaluara dhe aktuale.

2.11. Përfitimet e punëtorëve

Detyrimet pensionale

Kompania ka skemë të pensioneve të përcaktuara nga legjislacioni vendor i sigurimeve pensionale, sipas të cilës ajo kontribuon në planin e pas daljes në pension të punëtorëve të saj. Kontributet, bazuar në pagat bruto, janë bërë në planin e pensionit shtetëror, Trusti Pensional i Kosovës (TKPK) është përgjegjës për pagesën e pensioneve. Nuk ka asnjë detyrim shtesë në lidhje me këto plane. Për jo-rezidentët kontributet pensionale nuk llogariten dhe as nuk mbahen në burim.

2.12. Të hyrat

Të hyrat janë matur duke iu referuar vlerës së drejtë të konsideratës së pranuar apo të arkëtueshme nga kompania për shërbimet e ofruara, përjashtuar TVSH-në dhe zbritjeve tregtare. Të hyrat njihen kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, ka gjasa që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksione do të rrjedhin në kompani, shpenzimet e bëra ose që do të bëhen mund të maten me besueshmëri, dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur.

2.12.1 Të hyrat nga marketingu dhe sponsorizimi

Të hyrat nga marketingu dhe sponsorizimi përfshijnë të hyrat nga ofrimi i shërbimeve të reklamës dhe publikimeve përmes sponsorizimeve me kontrata. Këto shërbime realizohen në mënyrë proporcionale në aktivitetet sportive të ndeshjeve dhe jashtë tyre gjatë kohëzgjatjes dhe kushteve të kontratës. Të hyrat nga e drejta e sponsorizimeve njihen pas përmbushjes së kushteve të caktuara nga ana e klubit.

2.12.2 Të hyrat nga e drejta televizive

Të hyrat nga e drejta televizive paraqesin të hyrat nga kontratat me medijet kombtare dhe ndërkombtare. Këto të hyra realizohen në mënyrë proporcionale në momentin kur ndeshjet sportive zhvillohen gjatë sezonës së kampionateve. Të hyrat nga e drejta televizive njihen pas përmbushjes së kushteve të caktuara nga ana e klubit.

2.12.3 Të hyrat nga biletat

Të hyrat nga shitja e biletave paraqesin të hyrat nga biletat për ndeshjet kombtare, UEFA liga e klubeve, biletat vjetore, anëtarësitë dhe të hyrat tjera gjate aktiviteteve të ndeshjeve (miqësore etj).

Të hyrat nga biletat njihen në baza proporcionale në momentin kur zhvillohen ndeshjet gjate sezonës së kampionateve.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)***2.12.4 Të hyrat nga donacionet**

Donacionet janë dhurata të pakushtëzuara të kompensimit të cilat njihen kur pranohen. Donacionet regjistrohen në kontabilitet të klubit atëherë kur përmbushen kushtet e besimit që klubi do t'i përmbush kushtet për praninë të donacionit dhe që donacioni do të paguhet. Në llogaritë e fitimit dhe humbjes raportohet në mënyrë sistematike gjatë periudhës raportuese në të cilën shpenzimet njihen për të mbuluar donacionin e marrë.

2.12.5 Shpenzimet/ Te hyrat nga regjistrimet e lojtareve

Kostot e blerjes së regjistrimit të lojtareve kapitalizohen si më poshtë

Marrja e regjistrimit të lojtarit deklarohet në raportet financiare pasi të jenë plotësuar të gjitha kushtet e rëndësishme për transferim, pra transferimi në fakt është i pakushtëzuar, që do thotë se duhet të ketë një marrëveshje ligjrisht të detyrueshme ndërmjet dy klubeve dhe ndërmjet klubit që bleu regjistrimin e lojtarit dhe lojtarin.

Kapitalizohen vetem kostot e drejtperdrejta të marrjes së regjistrimit të lojtarit. Vlera e transferuar e një lojtari individual nuk mund të rivlerësohet më shumë, por menaxhmenti mund të besoj se vlera e tregut është më e lartë se vlera e transferuar. Kostot që lidhen me sektorin e vete të moshës së re të kërkuesve të licencës përfshihen në bilanc sepse ato kapitalizohen ekskluzivisht nga lojtarët e blerë.

Amortizimi fillon me marrjen e regjistrimit të lojtarit. Amortizimi ndërpritet në datën kur pasuria amortizohet plotësisht ose është tërheq në varësi të asaj që ka ndodhë më parë.

Per regjistrimin e cdo lojtari individual shuma amortizuese shpërndahet në mënyrë sistematike gjatë kohës së shfrytëzimit. Shpenzimet dhe te hyrat për transfer të lojtareve kompania i njeh në momentin kur paraja është realizuar apo transferi ka ndodhë.

2.13. Te pagueshmet tregtare dhe tjera

Të pagueshmet tjera dhe tregtare njihen në vlerën reale dhe më pastaj maten me kostot e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

2.14. Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Kërkesat për arkëtim njihen të arkëtueshme tregtare fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionit për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim e të arkëtueshmeve tregtare krijohet kur ka evidencë objektive që kompania nuk do të jetë në gjendje të alokoj të gjitha shumat sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Vështirësi me të rëndësishme të debitorit, probabiliteti që debitori do falimentoj apo do bëjë riorganizim financiar, dhe mos pagesa ose vështirësia në bërjen e pagesave (më shumë se 30 ditë vonesë) konsiderohen si tregues që të arkëtueshmeve tregtare janë të zhvlerësuara. Shuma e provizionit është diferenca mes vlerës bartëse të asetit dhe vlera aktuale e vlerësimit të rrjedhës së parasë në të ardhmen, të zbritura në normën fillestare të interesit. Asetet me maturitet të shkurtër nuk zbriten. Vlera bartëse e asetit zbritet përmes përdorimit të një llogarie të kompensimi, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse. Kur një e arkëtueshme tregtare është jo e alokueshme, ajo shlyhet kundër provizionit të saj. Rikuperimet pasuese të shumave të shlyera më parë njihen si të hyra të tjera në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse.

2.15. Huatë***Huazimet (Transferimi i fondeve - paratë shtesë për palët e lidhura)***

Huazimet nga aksionarët fillimisht njihen me kosto historike. Huamarrjet tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Huazimet janë kryer më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)***Kreditë bankare huatë**

Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe kreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së riblerjes që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes në bazat e interesit efektiv.

2.16. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje me shfrytëzimin e shërbimit ose në datën e origjinës së tyre.

2.17. Tatimet

Tatimet e pagueshme janë të bazuar në fitimet e vitit në bazë të Ligjit Nr. 06/L-105 mbi Tatimin në Korporatat. Fitimet e tatueshme dallojnë nga tatimi i raportuar në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse për arsye se i përjashton zërat e të hyrave dhe shpenzimeve të cilat janë të tatueshme apo të përjashtuara në vitet tjera dhe tërësisht përjashton zërat të cilat nuk pranohen asnjëherë. Obligimet e Kompanisë për tatimin e vitit kullohen në bazë të shkallës së tatimit 10%. Sipas legjislationit të tanishëm humbjet tatimore mund të barten për gjashtë vjet pas vitit të cilin humbja është shkaktuar.

2.18. Detyrimet e mundshme dhe provizionet

Detyrimet e mundshme nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse gjasat e ndodhjes se tyre dhe përfitimet ekonomike nuk janë larg. Një aset i mundshëm nuk njihet në pasqyra financiare, por shpaloset nëse pritet ndonjë fluks i përfitimeve ekonomike. Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, kompania ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që benifitet ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin. Më 31 dhjetor 2024, kompania nuk ka pasur provizione dhe detyrime të mundshme.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**3.1. Faktorët e riskut financiar**

Aktivitetet e kompanisë e vënë atë në një shumëllojshmëri të riskut financiar, duke përfshirë riskun e tregut, riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Menaxhimi i riskut të kompanisë përqendrohet në pa-parashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon që të minimizoj efektet e mundshme negative mbi performansën e biznesit të kompanisë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Menaxhmenti i Kompanisë të bazuar në disa politika dhe procedura paraprakisht të aprovuara me shkrim që mbulon plotësisht menaxhimin riskut.

3.2. Risku i tregut

Risku i tregut është risk që ndryshon në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojë në të ardhurat e kompanisë ose vlerën titujve të instrumenteve financiare të saj.

Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, derisa opti mizon kthimin

3.3. Risku i monedhës

Në përgjithësi, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të monedhës pasi që shumica e shitjeve të saj, blerjeve dhe huazimeve janë në valutën Euro.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

3.4. Risku i kredisë

Risku i kredisë është risk në humbjen financiare të kompanisë, nëse një klient ose homolog i një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij të kontraktuara, dhe linden kryesisht nga të arkëtueshme të kompanisë prej klientëve.

- Analiza e riskut të kredisë

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të përmbledhura si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
<u>Pasuritë financiare:</u>		
Paraja dhe ekuivalentët e saj	132,495	21,763
Llogari të arkëtueshme nga transferi lojtareve	4,000	4,000
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1,205,110	4,000
Pasuritë tjera afatshkurtra	100,235	48,979
Kerkesat tjera	63,200	63,200
<u>Detyrimet financiare:</u>		
Llogari të pagueshme dhe të tjera	-	106,631
Detyrimet tjera afatshkurtra	15,024	17,275
Detyrimet ndaj autoriteteve tatimore	187,787	40,045

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Më 31 dhjetor 2025, detyrimet e kompanisë kishin maturitet të kontraktuar (duke përfshirë pagesat e interesit, ku është e aplikueshme) ku ka një hapësirë të likuiditetit të përmbledhur si më poshtë:

Me 31 dhjetor	2025	2024
<u>Pasuritë qarkulluese</u>		
Paraja dhe ekuivalentët e saj	132,495	21,763
Llogari të arkëtueshme nga transferi lojtareve	4,000	4,000
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1,205,110	4,000
Pasuritë tjera afatshkurtra	100,235	48,979
Kerkesat tjera	63,200	63,200
Gjithsej pasuritë qarkulluese	1,505,039	141,942
<u>Detyrimet afatshkurta</u>		
Llogari të pagueshme dhe të tjera	-	106,631
Detyrimet tjera afatshkurtra	15,028	17,275
Detyrimet ndaj autoriteteve tatimore	187,787	40,045
Gjithsej detyrimet afatshkurta	202,815	163,951
Pozita e likuiditetit	1,302,224	(22,009)

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)***4. PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASE**

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Paraja ne bank BPB	132,495	21,763
<u>Gjithsej</u>	<u>132,495</u>	<u>21,763</u>

5. LLOGARITE E ARKETUESHME NGA TRANSFERI I LOJTAREVE

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
KF Malisheva	4,000	4,000
<u>Gjithsej</u>	<u>4,000</u>	<u>4,000</u>

6. LLOGARITE E ARKETUESHME

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Llogarite a arketueshme tregtare	1,205,110	4,000
<u>Gjithsej</u>	<u>1,205,110</u>	<u>4,000</u>

7. KERKESAT TJERA HUAVE DHENA

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Kerkesat ndaj huave tjera	63,200	63,200
<u>Gjithsej</u>	<u>63,200</u>	<u>63,200</u>

8. KERKESAT TJERA AFATSHKURTERA

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Pasurite tatimore-tvsh	100,235	48,979
<u>Gjithsej</u>	<u>100,235</u>	<u>48,979</u>

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

9. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Ndërtesa	Pajisjet dhe oriendi 20%	Autovetura 20%	Gjithsej
Kosto Historike:				
Me 01 janar 2024		5,064	8,567	13,631
Blerjet / Shtesa				-
Shitjet / (Heqjet)				-
Me 31 dhjetor 2024		5,064	8,567	13,631
Blerjet / Shtesa		6,181		6,181
Shitjet / (Heqjet)				-
Me 31 dhjetor 2025		11,181	8,567	19,812
ZHVLERËSIMI				
Balanca				
Me 01 janar 2024		(2,114)	(5,462)	(7,576)
Zhvlerësimi i periudhës		(973)	(1,713)	(2,686)
Rregullimet për heqjet				
Me 31 dhjetor 2024		(3,087)	(7,175)	(10,262)
Zhvlerësimi i periudhës		(1,775)	(1,391)	(3,166)
Rregullimet për heqjet				-
Me 31 dhjetor 2025		(4,862)	(8,566)	(13,428)
VNL me 01 janar 2024		2,950	3,104	6,054
VNL me 31 dhjetor 2024		1,977	1,392	3,369
VNL me 31 dhjetor 2025		6,384	-	6,384

FC DRITA SH.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

10. INVESTIMET NE VIJIM

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Investimet ne vijim -stadion	80,104	37,795
<u>Gjithsej</u>	<u>80,104</u>	<u>37,795</u>

11. KERKESA TJERA AFATGJATA

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Kerkesat ndaj kapitalit aksionareve	130,000	130,000
<u>Gjithsej</u>	<u>130,000</u>	<u>130,000</u>

12. HUAZIMET E DHENA AFATGJATA

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Fatos Ramadani	-	-
Fisnik Kerqeli	5,000	9,500
Valon Zymberi	-	1,000
Jahir Krasniqi	40,000	40,000
Driton Shkodra	40,500	40,500
<u>Gjithsej</u>	<u>85,500</u>	<u>91,000</u>

13. LLOGARITE E PAGUESHME TE PUNONJESVE

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Detyrimi ndaj punonjesve	-	106,631
<u>Gjithsej</u>	<u>-</u>	<u>106,631</u>

14. LLOGARITE E PAGUESHME

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Furnitoret	15,028	17,275
<u>Gjithsej</u>	<u>15,028</u>	<u>17,275</u>

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

15. DETYRIMET NDAJ TATIMEVE

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Detyrimet për tatimin e tvsh	-	-
Detyrimet për kontribute pensionale I	15,374	8,951
Detyrimet për tontribute pensionale II	15,374	8,951
Detyrimim për tatimin në burim në paga	47,739	22,143
Detyrimet për tatim në fitim	109,301	-
Gjithsej	187,788	40,045

16. TE HYRAT E SHTYRA

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Te hyrat e shtyra	398,800	-
Gjithsej	398,800	-

17. HUATE AFATGJATA NDAJ PERSONAVE TE LIDHUR

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Huate ndaj personave te lidhur	-	-
Flamur Bunjaku		173,000
Valon Murseli		178,000
Ilaz Shkodra		50,000
Gjithsej	-	401,000

18. KAPITALI

	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Flamur Bunjaku	75,000	75,000
Valon Murseli	75,000	75,000
Gjithsej	150,000	150,000

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

19. TE HYRAT NGA SHITJA

Per vitin qe perfundon më	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Te hyrat nga marketing	19,153	35,382
Te hyrat nga sponsorizimi	398,800	195,500
Te hyrat nga te drejtat televizive	168,640	66,150
Te hyrat nga shitja lojtareve	88,357	374,890
Te hyrat nga FFK	-	126,190
Te hyrat nga biletat	52,064	-
Te hyrat nga UEFA per zhvillim	-	-
Te hyrat nga UEFA	5,264,546	1,274,939
e hyrat tjera	4,695	28,846
Te hyrat e shtyra	(398,800)	
Gjithsej	5,597,455	2,101,896

20. KOSTO E SHERBIMEVE

Per vitin qe perfundon më	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Shpenzimet e Paisjeve Sportive	71,768	23,483
Shpenzimet e akomodimit dhe udhetimit	560,362	272,355
Shpenzimet e transportit	33,467	13,825
Shpenzimet mirëmbajtjes se fushës	6,217	50,847
Shpenzimet e sigurimit te ndeshjeve	1,500	4,345
Shpenzimet e FFK-së	4,290	2,205
Shpenzimet e transferit të lojtarëve	21,701	31,665
Shpenzimet e ushqimit te lojtarëve	35,065	24,225
Shpenzimet e pergaditjes fizike	5,533	-
Shpenzimet e shtypjes se biletave	10,638	6,482
Shpenzimet e organizimit te ndeshjes	17,046	-
Shpenzimet e shfrytezimit te fushës	-	7,339
Shpenzimet per sistemin GPS	-	12,804
Shpenzimet tjera(rregullimi tvsh-se)	-	37,534
Gjithsej	767,587	487,111

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

21. SHPENZIMET E PERFITIMIT TE LOJTAREVE

<u>Per vitin qe perfundon më</u>	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Shpenzimet e pagave te lojtareve	1,919,668	1,135,687
Shpenzimet e Kontributeve per lojtar	50,989	38,269
<u>Gjithsej</u>	<u>1,970,657</u>	<u>1,173,956</u>

22. SHPENZIMET E PERFITIMIT TE PUNONJESVE TJERE

<u>Per vitin qe perfundon më</u>	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Shpenzimet e pagave te shtabit teknik	427,197	202,437
Shpenzimet e kontributeve pensionale	7,800	4,629
Shpenzimet e pagave te stafit administrativ dhe tjere	653,301	316,989
Shpenzimet e kontributeve pensionale	32,581	15,295
<u>Gjithsej</u>	<u>1,120,879</u>	<u>539,350</u>

23. SHPENZIMET OPERATIVE

<u>Per vitin qe perfundon më</u>	<u>31 Dhjetor 2025</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
Shpenzimet e kontabilitetit	13,500	15,600
Shpenzimet e Auditimit	1,350	1,270
Shpenzimet e zyres dhe telefonit	8,456	5,392
Shpenzimet e provizioneve	5,962	2,837
Shpenzimet e Reklames dhe promovimit	22,157	20,676
Shpenzimet mjekesore	19,594	10,440
Shpenzimet e derivateve	2,698	3,433
Shpenzimet e mirëmbajtjes	1,910	2,992
Shpenzimet tjera operative	2,983	2,450
Shpenzimet e papranuara	72,461	57,466
Shpenzimet juridike	12,000	24,000
Shpenzimet financiare	54,830	22,200
Shpenzimet e licencimit	580	1,700
Shpenzimet e donacioneve	5,000	-
Shpenzimet e garancionit	2,266	-
Shpenzimet e reprezentacionit	3,662	-
<u>Gjithsej</u>	<u>229,409</u>	<u>170,456</u>

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

24. TATIMI NË FITIM

Tatimi mbi të ardhurat përbëhet nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024. Deklaratat tatimore paraqiten çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten provizore deri në kohën kur autoritetet tatimore ekzaminojnë kthimet dhe regjistrat e tatimpaguesit dhe lëshohet një vlerësim përfundimtar. Ligjet dhe rregulloret tatimore të Kosovës janë subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore.

Shpenzimet e tatimit në të ardhurat për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 është kalkuluar si më poshtë:

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Fitimi para tatimit	1,505,758	(176,664)
Korigjimet:		
Shpenzimet e papranuara	72,461	(57,466)
Zbritjet	-	-
Baza tatimore pas rregullimeve	1,578,218	(234,130)
Humbja e bartur tatimore	(185,207)	(76,915)
Baza tatimore para tatimit	1,393,011	(311,045)
Tatimi ne fitim (10%)	139,301	-

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Në lidhje me palët e lidhura, kompania aplikon rregulloren sipas SNK 24. Palët e lidhura përfshijnë:

- Palët të cilat në mënyrë direkte apo të tërthortë kontrollojnë ose janë të kontrolluara nga njësi ekonomike.
- Palët për të cilat kompania ka një interes që do të kishte një ndikim të rëndësishëm apo kontroll mbi kompaninë.
- Individët privat të cilët në mënyrë direkte apo indirekte kanë ndikim në vendimmarrjen e kompanisë duke filluar nga punëtorët, menaxhmenti e deri tek drejtorët e kompanisë.
- Kur merret parasysh çdo transaksion me palët e lidhura, vëmendjen më të madhe e ka përmbajtja e marrëdhënies e jo vetëm forma ligjore.

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, kompania kishte transaksionet e mëposhtme me palët e ndërlidhura:

Përshkrimi i transaksionit	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Kapitali		
Kerkesa kapital papaguar për aksionarët	130,000	130,000
Huazime nga palët e lidhura:		
Aksionaret	-	351,000

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

26.KONTINGJENTET DHE ZOTIMET

a) Zotimet kapitale

Nuk ka ndonjë zotim kapital domethënës të kontraktuar në datën e bilancit të gjendjes që tani më nuk është njohur në pasqyrat financiare.

b) Detyrimet ndaj tatimeve

Pasqyrat financiare dhe regjistrimet kontabël të kompanisë nuk janë audituar nga autoritetet e taksave (ATK) për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025, prandaj obligimet tatimore të kompanisë nuk mund të konsiderohen si të përfunduara.

27. NGJARJET PASUESE

Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë te pasqyrat financiare.